

IKShPK-ja u bënë thirrje qytetarëve të vaksinohen kundër gripit sezonal FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



NË KOSOVË ËSHTË DUKE U MBAJTUR FUSHATA ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE FAQE 4

FILLON SHTYPJA E FLETËVOTIMEVE PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT




Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka filluar shtypja e fletëvotimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 9 shkurt. Shtypja e

fletëvotimeve po realizohet në shtypshkronjën e dokumenteve me siguri të lartë, "Cetis", në Celje të Sllovenisë. Sipas vendimit të KQZ-së, do të shtypen 1 752 650 fletëvotime. Ky proces po

zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe është nën mbikëqyrjen e një delegacioni të KQZ-së të udhëhequr nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi dhe stafi i Sekretariatit të KQZ-së

AKTUALE



TRUMPI EMËRON AMBASADORIN E SHBA-së NË BE F. 2

PROKURORIA SPECIALE PO HETON 1 600 KONTRATA NJËBURIMORE F. 7

MAQEDONCI DHE JASHARI PRESIN NË TAKIM KONTINGJENTIN E FSK-së QË DO TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN "INTERFLEX" F. 7

EKONOMI



KOSOVA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR TREGTI TË LIRË ME EFTA-n F. 8

GËRHXHALIU, QEVERISË: MOS I SULMO BIZNESET, ATO JANË PASURI KOMBËTARE F. 8

SPORT



FHK-JA E ORGANIZON FAZËN NDËRKONTINENTALE TË IHF TROPHY F. 10

KUJTIMET E '99-S: HAPET MUZEU I FËMIJËVE TË LUFTËS F. 3



VOTAT E URREJTJES F. 6



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi emëron ambasadorin e ShBA-së në BE

WASHINGTON, 23 JANAR - Presidenti Donald Trump ka emëruar Andrew Puzder, i cili ka shërbyer si drejtor ekzekutiv i rrjetit të restoranteve fastfood 'CKE Restaurants', për postin e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në Bashkimin Evropian. Vendimi vjen një ditë pasi udhëheqësi i ri amerikan u zotua të godasë BE-në me tarifa. Puzder u propozua për të qenë sekretar i Departamentit të Punës gjatë administratës së parë të Trumpit, por u tërhoq mes shqetësimeve se nuk do të mund të siguronte

mjaftueshëm vota në Senat për t'u konfirmuar.

Presidenti Trump thotë se deficitit tregtar në mes të ShBA-së dhe BE-së është në nivele shqetësuese.

"Bashkimi Evropian është shumë, shumë i keq për ne", tha ai të martën, duke përsëritur komentet e bëra ditën kur mori detyrën. "Ndaj tarifatat janë e vetmja mënyrë për të pasur drejtësi".

Presidenti Trump i dha zë shqetësimit të tij mbi tarifatat gjatë komenteve për gazetaret në Shtëpinë e Bardhë pasi mori detyrën, por nuk vendosi

menjëherë tarifa siç kishte premtuar gjatë fushatës së tij. Trumpi i ka kërcënuar me tarifa Meksikën, Kanadanë dhe Kinën. "Andy do të bëjë një punë të shkëlqyer duke përfaqësuar interesat e kombit tonë në këtë rajon të rëndësishëm", tha presidenti, ndërsa njoftoi për emërimin e tij për ambasador të ShBA-së në BE.

Kur u emërua sekretar i Punës gjatë administratës së parë Trump, Puzder ishte në qendër të një vorbulle polemikash, ankimesh e konfliktesh të



mundshme.

Në vitin 2017 ai pranoi se ai dhe bashkëshortja e tij kishin punësuar një person pa dokumente. Ai u përball gjithashtu me një mori

ankesash dhe çështjesh ligjore të ngritura nga punonjës kundër bizneseve të tij. Puzder ka shërbyer drejtor ekzekutiv i 'CKE Restaurants' nga viti 2000 deri më 2017.

Rutte thotë se fitorja e Ruisë në Ukrainë do të sillte pasoja të mëdha për NATO-n

BRUKSEL, 23 JANAR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha të enjten se një fitore e Ruisë kundër Ukrainës do ta minonte fuqinë parandaluese të aleancës më të madhe ushtarake në botë dhe do t'i kushtonte asaj trilion euro për ta rikthyer besueshmërinë. NATO-ja është duke e rritur praninë përgjatë krahut lindor me Rusinë, Bjellorusinë dhe Ukrainën, pasi i ka dërguar atje mijëra trupa dhe pajisje për ta frenuar Moskën nga përhapja e luftës së saj edhe në territoret e ndonjërit prej 32 anëtarëve të aleancës. "Nëse Ukraina humb, atëherë për ta rikthyer fuqinë frenuese të pjesës tjetër të NATO-s, çmimi do të jetë shumë, shumë më i lartë sesa ai që po e shqyrtojmë në këtë kohë në lidhje me rritjen e shpenzimeve dhe të prodhimit tonë industrial", tha Rutte. "Nuk do të jenë miliarda shtesë; do të jenë trilion shtesë", shtoi ai, duke folur në margjinat e Forumit Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës. Rutte nguli këmbë se mbështetësit përëndimorë të



Ukrainës duhet "të rrisin, e jo ta zvogëlojnë mbështetjen" që janë duke ia dhënë asaj, pothuajse tre vjet pas fillimit të pushtimit të plotë nga Rusia. "Ne duhet ta ndryshojmë trajektoren e luftës", tha Rutte, duke shtuar se Perëndimi "nuk mund të lejojë që në shekullin XXI një shtet ta pushtojë një shtet tjetër dhe të përpiqet ta kolonizojë atë".

Në Evropë është duke u rritur

frika se presidenti amerikan Donald Trump mund të kërkojë t'i japë fund shpejt luftës duke mbajtur bisedime me presidentin rus Vladimir Putin, në kushte që janë të pavolitshme për Ukrainën, por Rutte u duk i kujdesshëm për të mos i bërë gjërat me nxitim. "Nëse kemi marrëveshje të keqe, ajo do të nënkuptonte se do ta shihnim presidentin e Ruisë duke festuar me liderët

e Koresë së Veriut, Iranit dhe Kinës, dhe këtë nuk mund ta pranojmë", tha ish-kryeministri holandez. "Ky do të ishte një gabim i madh gjeopolitik", shtoi Rutte.

I dërguari i ri i Trumpit për misionet të veçanta, Richard Grenell, i kritikoi aleatët që flasin për vazhdimin e luftës dhe vijojnë të mos i rrisin shpenzimet e tyre të mbrojtjes, sipas udhëzimeve të NATO-s. Ai tha se amerikanët mendojnë se është "skandaloz" që administrata Biden nuk pranoi të bisedojë me Putinin.

Liderët e NATO-s kanë janë pajtuar që çdo shtet anëtar duhet t'i shpenzojë të paktën 2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto për buxhetet e tyre ushtarake.

Aleanca vlerëson se 23 vende do ta arrijnë këtë cak këtë vit, megjithëse pothuajse një e treta do të mbetet prapa. Polonia dhe Estonia shpenzojnë më së shumti në bazë të PBB-së. "Nuk mund t'i kërkon popullit amerikan ta zgjerohet ombrellën e NATO-s kur anëtarët e tanishëm nuk po paguajnë pjesën që u takon

atyre", tha Grenelli.

Në ditët e fundit, Trumpi ka bërë komentet më të ashpra deri më sot ndaj Putinit, për të cilin shpesh ka folur me admirim.

Më 22 janar Trumpi, duke iu drejtuar homologut të tij rus me emër, paralajmëroi Moskën se do të përballet me tarifa, taksa dhe sanksione të reja "të larta" nëse nuk e ndal shpejt pushtimin e plotë të Ukrainës.

Një ditë më herët ai sugjeroi se do të vendoste sanksione shtesë ndaj Ruisë, nëse Putini nuk do t'i pranonte bisedimet për paqe për t'i dhënë fund luftës.

Dhe më 20 janar, në ditën e parë pas marrjes së mandatit të ri, Trumpi tha se Putini po e "shkatërron" Rusinë duke mos pranuar të bëjë një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës.

Lufta në Ukrainë filloi në vitin 2014 me pushtimin dhe aneksimin e paligjshëm të Gadishullit të Krimesë nga Kremli dhe u përshkallëzua me pushtimin e plotë të saj nga Rusia në shkurt 2022.

Gjykata Penale liron nga akuzat organizatorët e dhunës në Kuvendin maqedonas

SHKUP, 23 JANAR - Gjykata Themelore Penale e Shkupit vendosi më 23 janar të lirojë nga ndjekja penale ish-kryetarin e Kuvendit, Trajko Veljanovski, ish-ministrat Spiro Ristovski dhe Mile Janakievski, si dhe ish-drejtorin e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), Vladimir Atanasovski, të cilët ishin akuzuar si "organizatorë të ngjarjeve të dhunshme" në Kuvendin maqedonas më 27 prill 2017. Vendimi i gjykatës u bazua në mendimin e Prokurorisë

Themelore për ndjekjen e krimin të organizuar dhe korrupsionit, që sugjeronte zbatimin e Ligjit për Amnisti të vitit 2018.

Të akuzuarit u përballën me akuzën: "Kanosje terroriste e rendit kushtetues dhe sigurisë".

Gjykatësi Ilija Trpkov shpjegoi se ai personalisht, dhe Këshilli ende qëndrojnë në mendimin se qëllimi i ligjvënësve nuk ka qenë që t'i amnistojë organizatorët. "Por, në dispozitat e Ligjit për Amnistinë ekziston një

lidhje, sipas së cilës, Prokuroria Publike dhe ajo e Apelit, konsiderojnë se këta të pandehur nuk janë persona që kanë vepruar në kundërshtim me autoritetin e tyre zyrtar gjatë kryerjes së veprës penale të kërcënimit terrorist të rendit kushtetues", tha gjykatësi Ilija Trpkov, duke nënvizuar se vendimi për amnisti, ka të ngjarë të ngjallë edhe emocione.

Ky ishte procesi i dytë gjyqësor ndaj "organizatorëve të ngjarjeve të 27 prillit".



Kujtimet e '99-s: Hapet Muzeu i Fëmijëve të Luftës



PRISHTINË, 23 JANAR - Lëvizjet e shpejta të familjarëve dhe ikjes nga shtëpia... Strehimi në malet përreth fshatit... Mungesa ushqimesh... Zjarre... Të shtëna armësh... Shtëpi të djegura... Bagëti të vrara e të ngordhura...

Këto janë disa dromca kujtimesh që po sillte ndër mend Gent Behramaj, 31 vjeç, nga fshati Kotorr i Skenderajt, derisa lexonte citate rrëfimesh dhe shikonte lodra, makina druri, fustane kukullash e fotografi të ndryshme - që të gjitha të ekspozuara në Muzeun e Fëmijëve të Luftës në Prishtinë.

Ky muze - i pari i tillë në Kosovë - u hap më 22 janar nga organizata joqeveritare Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS).

Gjatë luftës në Kosovë, më 1999, Genti ishte 6 vjeç. Atëkohë thotë se nuk e kishte kuptuar se jetesa nën kërcënimet dhe rreziqet që sjell lufta, nuk është normale. "Gjërat e para që i kujtoj, janë lufta e dhuna. Më është dukur se ato janë normale. Më është dashur shumë kohë që ta kuptoj se nuk janë", thotë Genti për "Radion Evropa e Lirë".

Filikaçat nga gëzhojat e plumbave

Në njërin nga muret e Muzeut të Fëmijëve të Luftës është i shkruar citati: "Kur nuk kishim me çka të luanim, bënim filikaçka [v.j. pipëza për të fishkëlluar] nga gëzhojat e plumbave". "Ky është i imi",

thotë Genti duke treguar nga ai.

Fshati i tij gjatë luftës ishte sulmuar tri herë nga forcat serbe. Gjatë ofensivave banorët iknin dhe strehoheshin në malet përreth. Genti thotë se gjatë sulmit të dytë shtëpisë së tij i ishte vënë zjarri, sikurse edhe shumë të tjerave në fshat. "Kur jemi kthyer shtëpia ishte duke u djegur. Mbaj mend një kalë të vranë dhe disa lopë që i kemi pasur. E gjithë toka ka qenë e shtruar me gëzhoja të plumbave të shkrepur", kujton sot 31-vjeçari. "Nuk kemi pasur më lodra, nuk kemi pasur asgjë dhe e vetmja formë për të luajtur, ka qenë me filikaçka. I kemi shfrytëzuar gëzhojat e fishekëve si filikaçka. Mbase edhe jam gëzuar që kemi pasur diçka për të luajtur", thotë ai.

Thyerja e ciklit të harresës ndaj përvojave të fëmijëve

Rrëfimi i Gentit është një nga disa dhjetëra rrëfime të tjera, instalacione, fotografi e ekspozate, që janë bërë pjesë e ekspozitës "Loja e ndërprerë" në Muzeun e Fëmijëve të Luftës në Prishtinë.

Muzeu është alternativ dhe jotradicional, thotë për "Radion Evropa e Lirë" drejtoresha e tij, Bjeshkë Guri. Ajo tregon se rrëfimet e personave që kanë qenë fëmijë gjatë luftës janë mbledhur gjatë pesë vjetëve të fundit në zona të ndryshme të Kosovës, kryesisht në ato rurale. "E përbashkëta e tyre është se fëmijët gjithmonë

kanë qenë duke lozur. Për shembull, duke lozur kur bombardohen, duke lozur nëpër male, ku janë të fshehur... sepse loja është njëfarë nevoje imagjinare e fëmijëve për ta procesuar gjithë mllëfin dhe pasigurinë që janë duke përjetuar", thotë Guri për "Radion Evropa e Lirë".

Përvojat e ekspozuara, sipas saj, janë të fëmijëve të komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Secila e ka përshkrimin në shqip, serbisht dhe anglisht.

Guri thotë se muzeu do të përditësohet edhe me rrëfime dhe ekspozate të tjera.

Ideja dhe puna për themelimin e tij nisi pesë vjet më parë nga Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR). Ky është një rrjet rajonal i organizatave joqeveritare, i themeluar në vitin 2003, me programe në Serbi, Kroaci, Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë.

Drejtoresha e programit në Kosovë, Marigona Shabiu, thotë se ideja është inspiruar nga muzeu i ngjashëm i fëmijëve të luftës në Sarajevë, i cili ishte i vetmi i kësaj natyre në rajon. "Kjo tregon se sa pak përvojat e fëmijëve dhe fëmijët si subjekte, konsiderohen dhe merren parasysh, kur bëhet fjalë për narrativët e përgjithshëm për luftërat. Ne kemi dashur ta thyejmë këtë cikël të harresës dhe neglizhencës", thotë Shabiu për "Radion Evropa e Lirë".

Ajo thekson se muzeu është i rëndësishëm për kujtesën kolektive të luftës në Kosovë,

sidomos për fëmijët e sotëm, që të mësojnë për pasojat që lë lufta dhe dhuna. "Në këtë mënyrë, ta përçojmë edhe një mesazh për pajtim dhe për paqe. Paqja është diçka për të cilën ne duhet të luftojmë", thotë Shabiu.

Muzeu është hapur në hapësirat e organizatës YIHR në Prishtinë.

Nga kjo organizatë thonë se nuk kanë arritur të sigurojnë ndonjë hapësirë tjetër nga institucionet e vendit, por theksojnë se kanë marrë mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë, si Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Fondacioni Rockfeller Brothers.

Qeset që kujtojnë urinë

Qese të tilla mbanin ushqime të konservuara që hidheshin nga aeroplanët e forcave të NATO-s, menjëherë pas hyrjes së tyre në Kosovë, në qershorin e vitit 1999. Ato ishin ndihma për banorët, kryesisht në zona rurale, që kishin mbetur pa shtëpi dhe pa ushqime. Këto qese Genti thotë se mund të gjendeshin nëpër male e ara edhe disa vjet pas luftës.

Qesen e shndërruar tashmë në ekspozatë të muzeut, Genti thotë se e ka gjetur gati 15 vjet pas luftës dhe e ka ruajtur. "E dini se çfarë është më interesant? Kam shkuar me një shok serb nga veriu i Mitrovicës... kemi shkuar në fshatin tim. Isha duke i folur për këto kujtime dhe duke ecur, i kemi gjetur [qeset]. Për të ishte shokuese, sepse ishim

duke folur për këtë gjë dhe i gjetëm [qeset]", kujton Genti. Përgjatë një dekade pas luftës, Genti dhe familja e tij jetuan në Kotorr, në bodrume e garazhe të improvizuara dhe të përshtatura për banim.

Që nga viti 2010 u zhvendosën në një shtëpi me qira në Mitrovicë të Jugut - mbi 20 kilometra larg Skenderajt.

Genti i ka përfunduar studimet për Menaxhim të Marketingut, por fokus i tij ishte ndërtimi i paqes, ndaj është i angazhuar në organizatat joqeveritare lokale: Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë - CMB dhe Qendra "Hapësira Sociale për Dekonstruksion".

"Lufta për mua... pak problem, kur e mendoj që 25 vjet kanë kaluar dhe disi prapë nuk ka përfunduar... Ne, për shembull, nuk kemi pasur më shtëpi", shprehet Genti.

Qyteti ku jeton është i ndarë në jugun e banuar me shumicë shqiptare dhe veriu e banuar me shumicë serbe.

Në veri ka shpesh trazira, pasi popullata lokale serbe, edhe gati 26 vjet pas përfundimit të luftës, vështirë u bindet vendimeve të institucioneve në Prishtinë.

Kjo luftë në Kosovë ka lënë rreth 13 500 persona të vranë, në mesin e tyre mbi 1 000 fëmijë. Të zhdukur nga koha e luftës vazhdojnë të mbeten edhe mbi 1 600 persona, përfshirë 109 fëmijë. "Nuk kisha pasur qejf të kem armë, të marr armë, të prek apo të shoh armë. Nuk është gjë që më ka sjellë ndonjë të mirë në jetë, as mua e as ndonjë fëmijë këtu", përfundon Genti.



NË KOSOVË ËSHTË DUKE U MBAJTUR FUSHATA ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Fillon shtypja e fletëvotimeve për zgjedhjet e 9 shkurtit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka filluar shtypja e fletëvotimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 9 shkurt. Shtypja e fletëvotimeve po realizohet në shtypshkronjën e dokumenteve me siguri të lartë, "Cetis", në Celje të Sllovenisë. Sipas vendimit të KQZ-së, do të shtypen 1 752 650 fletëvotime. Ky proces po zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe është nën mbikëqyrjen e një delegacioni të KQZ-së të udhëhequr nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi dhe stafi i Sekretariatit të KQZ-së

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka filluar shtypja e fletëvotimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. Shtypja e fletëvotimeve po realizohet në shtypshkronjën e dokumenteve me siguri të lartë, "Cetis", në Celje të Sllovenisë. Ky proces po zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe është nën mbikëqyrjen e një delegacioni të KQZ-së të udhëhequr nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi dhe stafi i Sekretariatit të KQZ-së. Gjithashtu, përveç fletëvotimeve, janë duke u shtypur edhe

broshurat me listat e kandidatëve, të cilat do të jenë të disponueshme për votuesit në vendvotime gjatë ditës së zgjedhjeve. Në mbledhjen e mbajtur më 15 janar KQZ-ja mori vendim për numrin e fletëvotimeve dhe broshurave që do të shtypen. Sipas vendimit të KQZ-së, do të shtypen 1 752 650 fletëvotime, prej të cilave 1 664 100 për votimin në vendvotime të rregullta; 28 450 për votimin me kusht; 38 650 për votimin e personave me nevoja të veçanta dhe si fletëvotime rezervë; dhe 21 450 për votimin në përfaqësi diplomatike. Bazuar në Listën Votuese të certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, numri i

shtetasve të Kosovës me të drejtë vote është 2 075 868 votues, prej të cilëve 1 970 944 votues janë votues që i takojnë Listës Votuese brenda Kosovës dhe 104 924 votues janë pjesë e Listës Votuese jashtë Kosovës. Andaj, sipas vendimit të KQZ-së, do të shtypen 323 218 apo 15.57 % fletëvotime më pak se numri i votuesve. Kjo është një praktikë e ndjekur nga KQZ-ja edhe në proceset e kaluara zgjedhore. Secila parti e certifikuar mund të ketë deri në 110 kandidatë në listën zgjedhore. Nga këto lista do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit me 120 ulëse dhe deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Qeveria aktuale në Kosovë udhëhiqet nga Albin Kurti, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje. Nga 6 janari e deri më 8 shkurt mbi 100 mijë shtetas të Kosovës që jetojnë jashtë vendit do të mund të votojnë me postë për zgjedhjet parlamentare të Kosovës më 9 shkurt.

Diskutohet për planin operativ të Prokurorit të Shtetit në ditën e zgjedhjeve

Përfaqësues të Misionit Vëzhgues për Zgjedhje nga Bashkimi Evropian, kryesuar nga analistja ligjore e këtij misioni,

Eirini Skouzou, vizituan të enjten Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ku u pritën në takim nga Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, prokurorja nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Laura Pula. Gjatë këtij takimi u diskutua për rrjedhën e procesit zgjedhor për zgjedhjet nacionale në vendin tonë që do të mbahen më 9 shkurt 2025, me theks të veçantë u diskutua për planin operativ të Prokurorit të Shtetit në ditën e zgjedhjeve. Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, Pula, i informoi të pranishmit për angazhimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës për zgjedhjet nacionale që do të mbahen më 9 shkurt 2025. Po gjatë këtij takimi u diskutua për koordinimin në mes të prokurorive dhe Koordinatorës Nacionale lidhur me të gjitha aktivitetet e Prokurorit të Shtetit që do të ndërmerren në rast se do të ketë cenim të procesit zgjedhor, si dhe duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërinstucional në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit për procesin zgjedhor, në mes të institucioneve që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore. Ndërkaq, përfaqësuesit e

Misionit Vëzhgues për Zgjedhje nga Bashkimi Evropian informuan për angazhimin e vëzhguesve ndërkombëtarë në kuadër të këtij Misioni, për rolin e tyre dhe shpërndarjen e tyre në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Edhe Policia e Kosovës, bazuar në ligjet pozitive të vendit dhe autorizimeve si agjenci kyçe për sigurinë publike në tërë territorin e vendit, ka hartuar urdhrin operativ policor me kohë dhe ka bërë të gjitha planifikimet policore lidhur me "Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës" të cilat do të mbahen më 9 shkurt. Me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor është paraparë të angazhohet një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policorë, kryesisht të rendit publik por, sipas nevojës, mund të angazhohen edhe zyrtarë policorë të profileve të ndryshme, që iu përkasin njësiteve të ndryshme brenda Policisë së Kosovës. Ky plan operativ ka paraparë katër faza: 1) Periudha parazgjedhore apo përgatitore vlerësuese; 2) Angazhimi në ofrimin e sigurisë gjatë fushatës zgjedhore; 3) Garantimi i sigurisë në fazën kyçe të ditës së zgjedhjeve dita (Z); 4) Periudha pas zgjedhjeve që parasheh

Funksionalizohet nënstacioni 3 në Ferizaj, do të ndihmojë në përmirësimin e infrastrukturës energjetike

PRISHTINË, 23 JANAR - Është inauguruar Nënstacioni i ri Ferizaj 3, me kapacitet 110/35/10 kV, një arritje madhore në përmirësimin e infrastrukturës energjetike të Kosovës. Ky projekt strategjik, i realizuar me përkushtim dhe vizion, shënon një epokë të re në garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike.

Përtej rëndësisë teknike, ky investim i jashtëzakonshëm hap horizonte të reja për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale, duke krijuar kushte më të mira për qytetarët e Ferizajt dhe rajonit, si dhe duke vendosur një standard të ri për përparimin kombëtar.

Me këtë rast ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, u shpreh: "Ndërtimi i Nënstacionit Ferizaj 3 është një hap i rëndësishëm përpara për përmirësimin e angazhimit tonë për të

siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike. Ky projekt reflekton vizionin tonë për ta fuqizuar zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Ky është një investim strategjik që do të ketë ndikim të madh për shumë vjet në të ardhmen".

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT, Gëzim Tosuni, ka theksuar se sot shohim frytet e punës së palodhshme dhe vizionit për t'i përmbushur kërkesat në rritje për energji elektrike në Kosovë. "Nënstacioni Ferizaj 3 do të jetë një shtyllë kyçe për stabilitetin dhe sigurinë energjetike, duke sjell përfitime të mëdha për mijëra qytetarë dhe biznese", ka thënë ai.

Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT-it, Evetar Zeqiri, në fjalën tij ka theksuar se inaugurimi i Nënstacionit Ferizaj 3 është një dëshmi e përkushtimit



tonë të vazhdueshëm për të ndërtuar një rrjet të qëndrueshëm, modern dhe efikas në transminimin e energjisë elektrike. "Ky projekt jo vetëm që garanton furnizim

më të mirë dhe të qëndrueshëm për qytetarët dhe bizneset, por përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Shpreh mirënjohjen

time të thellë për të gjithë ata që kontribuuan me përkushtim dhe profesionalizëm në realizimin e këtij projekti jetik", ka deklaruar ai.

IKShPK-ja u bënë thirrje qytetarëve të vaksinohen kundër gripit sezonal

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 JANAR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve të vaksinohen kundër gripit sezonal, ndërkohë që javën e fundit, sipas numrit të rasteve të raportuara, intensiteti i gripit është në aktivitetin e lartë të qarkullimit, duke e kaluar pragun epidemik.

Kjo rritje rezultoi me rritje të fluksit të qytetarëve që kërkojnë ndihmë mjekësore në institucionet shëndetësore. Gripi sezonal është sëmundje akute infektive e cila te një



numër i konsideruar i rasteve shkakton komplikime serioze shëndetësore, veçanërisht te fëmijët, te moshuarit dhe ata me sëmundje kronike, ndërsa vaksinimi është mënyra më e

mirë për ta parandaluar gripin dhe shmangur rrezikun. Duke qenë se sezoni i gripit zgjat edhe për disa muaj, IKShPK u bënë thirrje të gjithë qytetarëve pa dallim moshe që

të vaksinohen si masë parandaluese, me theks të veçantë grupeve me prioritet si: Punëtorët shëndetësorë; Gratë shtatzëna; Personat me sëmundje kronike dhe me imunitet të komprometuar; Personat mbi 65 vjeç; dhe Fëmijët e moshës nga 6 muaj deri në 5 vjeç me indikacione shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë ka siguruar për këtë sezon 85 000 doza të vaksinës dhe qytetarët mund të vaksinohen në secilën komunë, në qendrën më të afërt të mjekësisë familjare.

IKShPK, gjithashtu, u bënë thirrje qytetarëve të zbatojnë

edhe masa të tjera parandaluese si mbajtjen e higjienës personale; Evitimin e kontakteve të afërta me individë të sëmurë; Reduktimin e vizitave të familjarëve te personat e hospitalizuar (ShSKUK, spitalet rajonale); Evitimin e vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz; Ushqimin e shëndetshëm me shumë vitamina; Aktivitet fizik dhe gjumë të mjaftueshëm; Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi; Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut.

transportin nën përcjellje dhe siguri të PK-së, të materialit sensitiv e deri në përfundim të procesit.

Faza e parë tani veçse është realizuar, përderisa tani jemi në fillim të zbatimit të fazës së dytë, për të vazhduar sipas planit me fazat e tjera, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

Sipas planifikimeve policore, qëllimi i këtij urdhri operativ për këtë proces zgjedhor është: Krijimi i një klime të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe mbajtja e rendit, qetësisë dhe sigurisë publike në vend para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve. Sigurimi i qendrave të votimit, këshillave komunale të zgjedhjeve, depove komunale, Qendrës së Numërimit të Rezultateve dhe depove qendrore. Përcjellja e sigurt dhe sigurimi i të gjithë materialit sensitiv zgjedhor nga

të gjitha destinacionet e parapara sipas planit të sigurisë deri në përfundimin e operacionit policor, që ndërlidhet me procesin zgjedhor. Inicimi dhe procedimi i çdo veprë penale kundër të drejtës së votimit dhe ndërmarrja e të gjitha masave procedurale/penale ndaj çdokujt që bie ndesh me ligjet pozitive të vendit që rregullojnë/sanksionojnë veprimet e kundërligjshme ndaj zgjedhjeve të lira dhe demokratike në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit sipas planeve të veprimit dhe marrëveshjeve paraprahe të bazuara në ligj.

Policia e Kosovës, bazuar në memorandumimin e bashkëpunimit në mes të Policisë, Prokurorisë dhe KQZ-së, ka caktuar zyrtarë/hetues në të gjitha drejtoritë rajonale për trajtimin e çdo rasti të

mundshëm që ndërlidhet me procesin zgjedhor, nën autorizimet e prokurorëve të caktuar për këtë çështje nga Prokuroria e Shtetit. Po ashtu, janë caktuar edhe koordinatorë të Policisë me KQZ-në si dhe janë dhënë udhëzime për zyrtarët policorë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore gjatë procesit zgjedhor. Policia e Kosovës ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë ligjore në mënyrë profesionale karshi qytetarëve dhe vendit si dhe të jetë transparente mbi punën dhe angazhimet policore.

Policia i ka inkurajuar qytetarët të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës dhe institucionet kompetente, njëherësh të raportojnë për çdo rast të kundërligjshëm që ndërlidhet me sigurinë dhe procesin zgjedhor, apo edhe jashtë tyre.



VOTAT E URREJTJES



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Fushatë e paparashikuar: Si asnjëherë më parë, fushata e subjekteve politike garuese kishte filluar 3 muaj para kohe, kryesisht në diasporë, ku VV-ja kishte monopol absolut. Partitë opozitare kanë investuar shumë në këtë fushatë elektorale jashtë vendit prandaj, pa asnjë dyshim, do t'ia përgjysmojnë votat partisë personale të Albin Kurtit, paradoksisht e quajtur VV. Përveç emërimit, si ambalazhim, as përmbajtja e as veprimi politik nuk kanë të bëjnë me vetëvendosjen, si shprehje e lirë e vullnetit qytetar për ta organizuar jetën politike apo kornizën ku do ta vendosin atë përcaktim të lirë të vullnetit, përmes referendumit apo një mënyre tjetër.

Zakonisht, në vendet ku demokracia është në pampersa, Kosova është e tillë, në fushata elektorale opozita shfaq dhe zbaton agresivitet verbal të shoqëruara edhe me dhunë fizike. Te ne ndodhë e kundërta, pozita po e përdorë një dhunë jonormale verbale kurse opozita po sillt sikur demokracia buron nga opozita e që paraqet problem t'i besohet krejtësisht. Shkojmë pra radhas, sipas fuqisë politike.

1. VV: Për habinë time e ka të dështuar fushatën, qëllimisht apo pa vetëdije, nuk ka fare rëndësi. Thuaja e tërë skuadra po luan sipas pulsit të Albin Kurtit përjashtuar rastit të akademikut Agim Bahtirit që në mbrojtje të kredos intelektuale, politike, filozofike, po del nga skema kurtiane duke mbrojtur fuqishëm injorancën dhe analfabetizmin që e ka edhe për eksport. Deri më tani eruditët e mendimit politik të VV-së, Dimal Basha, Mefail Bajçinovci, ekstazitë e Prizrenit, Halil Thaçi, Pambuke Nagavci - pevaçica e VV-së, Zdravo Zemljak Mimoza, Krokama nga Parisi e disa të tjerë, si pak po dëgjohen duke e bërë mjedisin shoqëror më të pastër. Kontribut i ekologjisë. Albini e ka përshkallëzuar

dhunën verbale ndaj opozitës, mediave, prokurorëve dhe gjykatësve, Gjykatës Kushtetuese, ndaj të gjithëve që po e shkelin në kallo. Në përshkallëzim të dhunës orale, po shquhet sidomos peci i Albin Kurtit, dikur i Vojsës. Pastaj Shvarci nga Gjermania si dhe "ekspertja" për floktari, dizajnim të fundeve për meshkuj femra të VV-së dhe mprehje të thonjve për t'i nxjerrë sytë opozitës e që për snobët quhet manikyr - pedikyr. Kjo ministri quhet: "hair ozon - Lena". As ashtuhi e as kështuhi, pa integritet anatomik dhe politik, po e luan rolin e tapës dhe harrnit për t'i mbyllur birat dhe arnuar vrimat e Albin Kurtit. E fundit ishte një denoncim krejtësisht i pamoralshëm kundër Obamës dhe Bajdenit se paskan qenë proserbë, antishqiptarë dhe se e paskan degraduar çështjen e Kosovë të cilën e paska mbrojtur Besnik Bislimi, ky rrenc dhe mashtrues patologjik. Kur Bajdeni e pati mundur Trampin në zgjedhjet e parafundit, Albin Kurti e pati denoncuar poshtërisht Trampin te Bajdeni, për ta fituar mëshirën e tij. Tash, edhe Bajdeni qenka i keq për VV-në kurse Trampi i mirë. Mbështetur në konvertimet politike përmes goditjeve morale kam përshtypjen që në vizitën e parë të Grenellit në Kosovë, nëse VV-ja do të jetë në pushtet, "mashqit e fortë" të VV-së do ta presin të veshur me mbathje tanga. Albin Kurti nuk ka nevojë të bërtas, të shajë, të fyjë apo nënçmojë askënd, së paku opozitën sepse mund të qeverisë me ta. Pastaj votuesit që elektrizohen me këtë dhunë verbale, në planin afatgjatë nuk i duhen askujt, së paku Kurtit. Njeriu që ka fituar mbi 50 për qind të votave duhet ta ketë një kulturë të komunikimit, të jetë përafres me të gjithë, i durueshëm, këshillëpranues, mëshirues dhe kundërshtues i çdo dhune, verbale apo fizike. Mënyra si po e bënë fushatën, më shumë më bindë se Albini nuk e ka qëllim fitoren. Albini edhe nëse po përpiket të aktrojë, keq po e bënë, po i duket si i braktisuri i "çlirimtarit të Shtimes". Albin Kurti po shfaq urrejtje patologjike kundër UÇK-së dhe ushtarëve të lirisë sepse i identifikon me Hashim Thaçin, të cilin e urren përtej çdo patologjie. Dikur kështu e urrente edhe Rugovën, sot derdhë lot aligatori për të.

Albini nuk e do e as nuk e respekton as Bacë Adem Demaçin, madje as Dejana Mihalini, kësulkuqen e VV-së që e ka vendosur një kapelë të kuqe me shpresë se do ta hajë ndonjë ujë i uritur. Me gjasë nuk do ta hajë as qeni topall i Albin Kurtit që e përdorte në zgjedhjet e fundit si kapital elektorale. Gjuha e urrejtjes e Kurtit dhe krijesave me formë anatomike njerëzore por me përmbajtje në kundërshtim me çdo gjë njerëzore si puna e pecit të Albin Kurtit, Donika Shvarci, Lenka Çukos, Haxhi Çamilit, Agim Kajrafilit dhe Besnik Rrenc Bislimit nuk sjellin vota normale por vota të ndyra, të kontaminuara që herët a vonë do të shkaktojnë probleme të mëdha midis shqiptarëve patriotë dhe shqipfolësve jopatriotë, nostalgjikë të Jugosllavisë dhe Serbisë. Zdravo Mimoza! Se në ç'pikë ka rënë morali në Kosovë lehtë e kuptoni kur një "intelektual" i profilit aq të ulët moralisht e quan opozitën bërlllok. Xhelat ziu dhe dhunuesi më i madh i policisë së Kosovës e tha këtë, pa e trembur çerpikun. Albin Kurti ka probleme të mëdhame veten. Me përgjegjësi morale paç i ka punët, e ka diçka fakultative prandaj, pa fije turpi kërkon prokurorë patriotë kur në partinë që e sundon, specia më e rrallë e që janë në zhdukje e sipër janë pikërisht patriotët. Albini edhe patriotizmin e ja jodetyrues, fakultativ, e përdorë për vota dhe pushtet, jo për shtet. Prandaj fundin politik nuk mund ta ketë të mirë, keq do të përfundojë. Në fushatë Albini vet është dirigjenti, vet është violina e parë, klarinetisti dhe tupanxhiu, saksofonisti dhe kitaristi. I ngjanë dirigjenti të një filharmonie të çakorduar ku spikatet zëri i një kukuvajkeje si Pambuje Nagavci që i mbajnë ison disa ministre që kanë kaluar nëpër duart e kirurgut për korrigjime estetike që përkundër talentit dhe mundit, nuk është se kanë bërë ndonjë përparim dramatik. Përveç se ua janë nxjerrë urrejtjen dhe shëmtinë shpirtërore. As kontributi i analistit të shquar nga Gjylekari që veprat analitike i boton të mbështjella me mbështjellës plastmasi, sikur të ishin pornografike e që për mua janë kryevepra të pornografisë intelektuale, prof. dr. Ramçe nga Gjylekari nuk i ndihmojnë Binit. As makroi i pornografisë

dezinformative në RTK, Rilindi, i vdekur për së gjalli nuk ia rritë potencën politike dhe elektorale të Kurtit. As kapja e KPM-së nga rrogëtarët besnikë të të gjitha regjimeve, nuk e nxjerrin Kurtin nga balta e gjallë. Dikur qeshnin me Ramushin duke i thënë se iu kanë lodhur "mashqit". Duket se tash Albini iu kanë lodhur fort mashqit, nëse ka pasur të tillë në partinë që e sundon. Madje, fort është lodhur edhe vet kryemashkulli, Albin Kurti, prandaj po bërtet aq shumë. Zoti i ndihmoftë!

2. PDK: Duket se është forcuar por jo se ka mbledhur mend nga pësimi në zgjedhjet e fundit. Listën për deputetë e ka shumë të mirë, kombinim i krahut të luftës dhe ardhmërisë demokratike. Mendoj se i mungon një autoritet vendimmarrës për vendime të rënda. E kanë hurrur listën nga keqbërës dhe përfitues të pamerituar. Është ky një kapërcim cilësor. Në zgjedhjet e fundit PDK-ja ka humbur nga koalicioni kundër UÇK-së, VV-së, Guxos, Alternativës, Donika Shvarci dhe Vojsa Osmanit, në krye Gjykata Speciale Raciste, me bukuroshen Trandafilova. Për bindjen time Albin Kurti është në një udhëkryq të madh ku çdo rrugë e futë në një labirint pa dalje. Këtu PDK-ja e ka shansin për rikthim që ta çojë lavdinë e UÇK-së në vend. A do ta shfrytëzojë këtë mundësi? E shohim pas datës 9 shkurt.

3. LDK: Renegatët Vojsa Osmani, Donika Shvarci, peci i Albin Kurtit, Haxhi Qamili dhe kuislingët tjerë e gjymtuan LDK-në për një bythë karrige. Tash mund të mbesin ne bythë të zhveshura, pa pushtet, si vegla për punë të ndyra të Albin Babës. Votuesit e vërtetë të LDK-së do t'i kthehen partisë, prandaj LDK-ja do ta ketë rritjen më të madhe. LDK-ja po e bënë fushatën e strukturuar dhe të kombinuar, demokratike në pamje kurse provokimeve të Kurtit po iu përgjigjet cep më cep dhe dhëmb për dhëmb. Ky agresivitet në përgjigje ndaj Kurtit dhe ndërmarrjes së tij dhunuese po i mungon PDK-së e që është gabim.

4. AAK - NISMA: Po bënë fushatë për 100.000 vota. Ramushi ka intuitë politike, e kapë momentin në kohën e duhur dhe në vendin e duhur. Po gjen lidhje dhe mundësi të

jetë afër amerikanëve, afër Trampit. Këtë e përdorë edhe gjatë fushatës. Mbase do të jetë përcaktues për koalicionin e ardhshëm. Ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën çlirimtare, përsëri do të luftonte nëse e lypë puna. Nëse nuk i ecën politika mund të bëjë karrierë fenomenale në muzikë në duet mePambuke Nagavcin.

5. Koalicioni për Familjen: E ka një klimë të favorshme për inkasim të votave të besimtarëve dhe mbrojtësve të familjes sidomos pasi Trampi, pa ekuivoqe tha se në Amerikë janë vetëm dy gjini, mashkull dhe femër. Qëndrim fenomenal dhe i pakundërshtueshëm. Një infuzion domethënës, i fuqishëm dhe i jashtëzakonshëm për koalicionin për Familjen që ta kalojë pragun duke kapërcyer ngjyrat e Ylberit. Rezultatet e mundshme të përkthyer në deputetë: Nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të diel këto do të ishin rezultatet:

VV-ja, maksimalisht **34 deputetë**.

PDK-ja, maksimalisht **26 deputetë**.

LDK-ja, maksimalisht **24 deputetë**.

AAK - NISMA, maksimalisht **12 deputetë**.

Koalicioni për Familje, **4 - 6 deputetë**.

Marzha e lejuar e gabimit është plus - minus 3 për qind. Deri në ditën e zgjedhjeve mund të ketë ndryshime në radhitje. Por, në asnjë rrethanë nuk e shoh VV-në në qeveri e as Kurtin si kryeministër. Kosova do të vendoset me supe në mur, me oferta të liga politike e cila do të dobësohet sa më shumë të kalojë koha. Do të jetë sukses i jashtëzakonshëm nëse zhbëhet marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit dhe nëse ruhet integriteti territorial i Kosovës. Në të kundërtën bashkimi me Shqipërinë është i pashmangshëm. Për ta ruajtur paqen duhet të bëhemi gati për luftë. Këta që po qeverisin nuk janë as për paqe e as nuk kanë k..e për luftë. I fusin patatet në furrë për t'ua lënë të tjerëve në duar. Prandaj e bëjnë kështu fushatën, për të mbijetuar pa rrezikuar asgjë. Do iu del e kundërta, as nuk do të fitojnë, as nuk do të mbijetojnë e as nuk do të shpëtojnë. KA ZOT!

Maqedonci dhe Jashari presin në takim kontingjentin e FSK-së që do të marrë pjesë në operacionin "Interflex"

PRISHTINË, 23 JANAR - Komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Bashkim Jashari, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, pritën në takim kontingjentin e FSK-së, i cili do të marrë pjesë në Operacionin "Interflex", që do të realizohet në Mbretërinë e Bashkuar, për t'i trajnuar trupat ukrainase. Ata i uruan suksese kontingjentit të FSK-

së gjatë realizimit të këtij operacioni dhe, në të njëjtën kohë, kërkuan prej tij të tregojë profesionalizëm, përkushtim dhe disiplinë në mënyrë që ky kontingjent ta përfaqësojë sa më mirë Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Republikën e Kosovës. Operacioni "Interflex" është operacion shumëkombësh me qëllim të përgatitjes dhe aftësimin të ushtrisë ukrainase

në luftën për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial nga agresioni rus. Gjatë këtij operacioni gjashtëmuor të udhëhequr nga Mbretëria e Bashkuar, pjesëtarët tanë, së bashku me ushtarakë nga vendet e tjera, do të angazhohen si instruktorë për trajnimin e Forcave të Armatosura të Ukrainës në detyra të ndryshme luftarake.



Monitorimi i medieve, rrjeteve sociale dhe dezinformatave, prioritet për Misionin e BE-së gjatë zgjedhjeve në Kosovë

PRISHTINË, 23 JANAR - Shefja e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM), Nathalie Loiseau, në një intervistë për Telegrafin ka folur për procesin e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë.

Loiseau ka ndarë pikëpamjet e saj edhe për fushatën zgjedhore dhe raportimin e medieve në këtë rast. Ajo ka theksuar se Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve përfshin një ekip të përkushtuar monitorues të medias që ekzaminon nga afër një mostër të mbulimit të medieve transmetuese gjatë fushatës zgjedhore. "Fokusi ynë është në vlerësimin, nëse media i ofron elektoratit informacion adekuat dhe mbulim të drejtë të të gjithë aktorëve të zgjedhjeve, duke përfshirë partitë politike, kandidatët dhe qeverinë", ka deklaruar Loiseau.

Loiseau ka shtuar se për të arritur këtë vlerësim do të analizojnë një mostër përfaqësuese të medieve transmetuese dhe online, duke përfshirë kanalet televizive në gjuhën serbe. "Analiza jonë është sasiore dhe cilësore, duke vlerësuar kohën dhe tonin e programeve që u ndahen aktorëve politikë. Kjo na ndihmon të vlerësojmë nëse media synon mbulim të balancuar dhe i siguron elektoratit informacion të mjaftueshëm për të bërë zgjedhje të informuara. Gjetjet do të jenë pjesë përbërëse e



vlerësimit tonë përfundimtar, pasi mbulimi mediatik i fushatës luan një rol kryesor në

transparencën dhe drejtësinë në procesin zgjedhor", ka deklaruar Loiseau për

Telegrafin. Shefja e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve ka

shprehur shqetësimin e saj edhe për situatën e krijuar në Komisionin e Pavarur të Mediave. "Si pjesë e kësaj ne po e përcjellim nga afër edhe situatën e KPM-së, e cila aktualisht është e paqartë. Jemi duke e vlerësuar situatën dhe nëse ka implikime në procesin zgjedhor", tha ajo.

Nathalie Loiseau gjithashtu bëri me dije se, përveç monitorimit të medieve në aspektin e raportimit për fushatën zgjedhore, Misioni i BE-së do ta monitorojë edhe çështjen e keqinformimit, propagandës dhe dezinformatave. "Natyrishment ne jemi të vetëdijshëm për keqpërdorimin e mundshëm të medieve sociale, veçanërisht rreth zgjedhjeve. Kjo është një çështje që prek shoqëritë kudo, jo vetëm në Evropë apo Kosovë. Misioni (EU EOM) i BE-së ka një ekip të përkushtuar ndaj medieve sociale që monitoron përmbajtjen që vijnë nga burime të ndryshme, si nga komunitetet shumicë, po ashtu edhe nga ato joshumicë", ka deklaruar Loiseau.

Loiseau ka shtuar se, përveç dezinformatave dhe keqinformimit, po monitorojnë edhe gjuhën nxitëse dhe nënçmuese dhe gjuhën e urrejtjes, si dhe portretizimin në rrjetet sociale të grave, personave me aftësi të kufizuara dhe komuniteteve LGBTQ në kontekst të zgjedhjeve.

Prokuroria Speciale po heton 1 600 kontrata njëburimore

PRISHTINË, 23 JANAR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) është duke hetuar 1 600 kontrata njëburimore. Këtë e ka bërë me dije zëvendëskryeprokurori i kësaj prokurorie, Valdet Gashi, derisa ka paraqitur raportin vjetor të punës së kësaj prokurorie, në mbledhjen e 261-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).

Anëtari i KPK-së, Arian Gashi, ka pyetur se pse ka një disbalancë në mes të lëndëve të kryera të disa prokurorë, duke thënë se disa prej tyre kanë kryer vetëm gjysmën e

lëndëve që kanë në punë, e disa prej tyre dyfishin e tyre, duke qenë se PSRK-së i janë shtuar 9 prokurorë të rinj.

Për këtë, zëvendëskryeprokurori Gashi është përgjigjur duke thënë se prokurorët e rinj kanë filluar punën në qershor të vitit të kaluar dhe janë angazhuar për hetimin e kontratave njëburimore. Sipas tij, po hetohen 1 600 kontrata njëburimore për të cilat tha se nuk ka informacione dhe duhet të analizohen, për çka tha se janë aktivizuar dhe janë duke pritur informata nga policia.

Ai ka thënë se këto raste kanë krijuar këtë disbalancë mes prokurorëve.

Gashi ka bërë me dije se Prokuroria Speciale në 2024-n ka bartur 1 757 lëndë nga viti 2023 dhe janë pranuar 489 lëndë të reja. Ai tha se në 2024-n janë zgjedhur 288 lëndë, apo 58.9 për qind e lëndëve të pranuar.

Gashi ka thënë se në 2023-n puna e kryerjes është më e lartë, por në 2024-n janë ballafaquar me sfida siç është ndryshimi i Ligjit për PSRK-në, siç ka vendosur edhe disa pozita për zyrtarë që më herët kanë qenë në Themelore.



Gërxhaliu, qeverisë: Mos i sulmoni bizneset, ato janë pasuri kombëtare

PRISHTINË, 23 JANAR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka kërkuar nga qeveria Kurti që mos t'i sulmojë bizneset. "Mjaft me sulme! Dje Devolli, sot Interexi. Le t'i mbështesim bizneset vendore për të ardhmen e Kosovës", ka shkruar ai në "Facebook". Ai ka thënë se në vend të akuzave, duhet t'i mbështesim bizneset vendore për të ardhmen e Kosovës. "Në ditët e fundit kemi parë sulme të paarsyeshme dhe të organizuara kundër korporatave të mëdha si Devolli dhe Interex, kompani që kanë dëshmuar se janë shtylla të forta të ekonomisë sonë. Interex, nën udhëheqjen e Shaip Mikullovcit, është një

shembull i shkëlqyer i ndërmarrësisë së suksesshme në Kosovë. Kjo kompani ka kontribuar në mënyrë të jashtëzakonshme përmes krijimit të vendeve të punës, mbështetjes së prodhuesve vendorë dhe pagesës së tatimeve që mbajnë gjallë institucionet tona", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se sulmet ndaj këtyre kompanive nuk janë të rastësishme. "Ato synojnë të dobësojnë sektorin privat dhe të gjunjëzojnë ekonominë kosovare. Kjo strategji e dëmshme vjen në një kohë kur bizneset tona po tregojnë se mund të konkurrojnë me brendet më të mëdha në rajon dhe Evropë, duke promovuar imazhin e Kosovës si një vend i

qëndrueshëm dhe me potencial të jashtëzakonshëm. Në Kosovë, sektori privat ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol vendimtar në ndërtimin e shtetit dhe zhvillimin ekonomik. Bizneset janë shtylla e ekonomisë sonë, duke krijuar vende pune, duke kontribuar në buxhetin e shtetit përmes tatimeve, dhe duke ndihmuar në forcimin e pavarësisë ekonomike të vendit. Megjithatë, në vend që të mbështeten, ato shpesh goditen nga institucionet dhe shoqëria, duke përcarë komunitetin dhe duke dëmtuar themelet e një ekonomie të shëndetshme", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka shtuar se bizneset nuk janë vetëm pronë e individëve



apo familjeve që i udhëheqin, ato janë pasuri e përbashkët e shoqërisë. "Si shoqëri duhet t'i japim fund kësaj qasjeje shkatërruese ndaj sektorit privat. Bizneset janë një pasuri kombëtare që duhet mbrojtur

dhe promovuar. Vetëm përmes një bashkëpunimi të sinqertë mes institucioneve, shoqërisë dhe bizneseve mund të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për Kosovën", ka theksuar Gërxhaliu.

Kosova nënshkruan Marrëveshje për Tregti të Lirë me EFTA-n

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 JANAR - Kosova ka nënshkruar Marrëveshje për Tregti të Lirë me shtetet e Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë (EFTA), ku bëjnë pjesë Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra. Në ceremoninë e nënshkrimit në Davos të Zvicrës, anëtarët e EFTA-s dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, thanë se kjo marrëveshje do të sjellë përfitime të dyanshme.

Marrëveshja ofron mundësi të shumta, përfshirë për importimin dhe eksportimin e mallrave. Produktet me origjinë nga Kosova do të mund të eksportohen në vendet e EFTA-s dhe kompanitë vendore nuk do të kenë nevojë të paguajnë tarifë doganore për to. Deri më tani prodhuesit vendorë janë detyruar të paguajnë deri në 10 për qind tarifë shtesë doganore. Marrëveshja u arrit pas më shumë se dy vjetësh negociata dhe, sipas kryesueses së EFTA-s, Cecilie Myrseth, Kosova është vendi i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që në këtë



marrëveshje, me kërkesë të saj, ka përfshirë edhe shërbimet. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se me këtë marrëveshje hapet kapitulli i përfundimit i raporteve ekonomike, por edhe i avancimit të raporteve tregtare në mes të shtetit të tij dhe anëtarëve të EFTA-s. "Marrëveshja që nënshkruajmë sot themelon një kornizë për marrëdhënie tregtare midis

shteteve të EFTA-s dhe Kosovës si dhe do të krijojë mundësi të reja duke i dhënë Kosovës qasje në tregjet e EFTA-s. Këtu hapen mundësi të reja eksporti për bizneset tona dhe integrim më i thellë në kornizën ekonomike evropiane, duke na mundësuar të garojmë në një shkallë të gjerë", tha Kurti gjatë ceremonisë së nënshkrimit. Kryeministri Kurti tha se është i bindur se kjo marrëveshje do të

sjellë përfitime për bizneset, industrinë dhe qytetarët. Kryesuesja e EFTA-s, Cecilie Myrseth, tha se kjo marrëveshje është arritje e madhe për integrimin e Kosovës në sistemin global. "Jam e bindur se kjo do ta shtyjë përpara rritjen ekonomike, duke krijuar mundësi për bizneset e reja dhe qytetarët në të dyja palët", tha ajo. Vitin e kaluar Kosova ka shënuar

rritje ekonomike rreth 4 për qind dhe rënie të inflacionit, por shteti përballet me nivel të lartë të importit krahasuar me atë të eksportit.

Myrseth nga EFTA tha se në vitet e fundit tregtia mes shteteve të EFTA-s është rritur shumë dhe ka arritur në mbi 176 milionë euro. "Me lidhjen e Marrëveshjes për Tregti të Lirë mund të presim që tregtia të rritet edhe më shumë", theksoi ajo.

EFTA tha se, përveç shërbimeve financiare, janë përfshirë edhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Kosova tha se me marrëveshja të tilla synon t'i tërheqë investitorët e huaj që të investojnë në vend.

EFTA është krijuar më 1960 me synimin që ta promovojë tregtinë e lirë.

Marrëveshje për Tregti të Lirë Kosova ka nënshkruar edhe me vendet e Evropës Qendrore (CEFTA). Kjo marrëveshje, ku bëjnë pjesë shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavia, synon rritjen e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, eliminimin e barrierave tregtare mes palëve dhe tërheqjen e investimeve.

Modifikohet formulari "WR" për tatimet e mbajtura në burim

PRISHTINË, 23 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se është modifikuar formulari "WR" përmes të cilit deklarohen tatimet e mbajtura në burim, si: tatimi në interes, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari, lojëra të fatit dhe tatimi për personin jorezident.

Ndryshimet në formularin e lartcekur "WR" aplikohen nga periudha janar/2025. Këto ndryshime lehtësojnë përfundimin e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit, të cilët realizojnë transaksione



ndërkombëtare, ndërsa për tatimpaguesit që realizojnë transaksione brenda vendit nuk kanë ndikim. Në listën (excel file) e cila ngarkohet me rastin e

dorëzimit të formularit "WR", është shtuar një kolonë e re "Shteti" në të cilën tatimpaguesit duhet të vendosin emrin e shtetit me të cilin kanë realizuar

transaksione ndërkombëtare. "Nga periudha janar/2025 e tutje, përderisa tatimpaguesit deklarohen formularin 'WR' përmes listës së re, në të cilën plotësohet edhe informata për shtetin me të cilin personi ka transaksione ndërkombëtare, nuk kërkohet që të dorëzohen në ATK edhe formularët për zbatimin e Marrëveshjeve për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, siç është kërkuar deri më tani", ka njoftuar ATK-ja. Nga viti/2025 e tutje nuk kërkohet që tatimpaguesit të dorëzojnë në ATK formularët,

si: 1. Formulari - Të ardhurat nga Interesi; 2. Formulari - Të ardhurat nga Dividenda; 3. Formulari - Të ardhurat nga të Drejtat Pronësore; 4. Formulari - Fitimet Kapitale; 5. Formulari - Të Ardhurat tjera; 6. Formulari - Të ardhura nga Shërbimet e Pavarura; 7. Formulari - Të ardhura nga Shërbimet e Varura; dhe 8. Formulari - Të ardhurat nga Fitimet Biznesore. Këto ndryshime synojnë ta rrisin efikasitetin dhe ta zvogëlojnë barrën administrative për tatimpaguesit.

Kush mund ta blejë TikTok-un?



Presidenti Donald Trump i ka dhënë TikTok-ut një afat prej 75 ditësh për të bindur zyrtarët amerikanë se nuk përbën një kërcënim për sigurinë kombëtare. Zgjidhja më e mundshme? Gjetja e një pronari të ri për operacionet e aplikacionit në SHBA. Ja disa prej emrave që mund të marrin pronësinë e platformës së famshme.

MrBeast

Youtuber-i i njohur MrBeast, emri i vërtetë i të cilit është Jimmy Donaldson, ka shkaktuar bujë me deklaratën e tij më 14 janar: "Mirë, do ta blej TikTok-un që të mos ndalohej." Kjo deklaratë u mor

seriozisht nga shumë ndjekës, duke çuar në kontakte me miliarderë që po shqyrtojnë mundësinë e blerjes së platformës. Ai ka postuar disa herë për përfshirjen e tij në diskutime dhe madje ka sugjeruar se mund të bëhet CEO i ri i TikTok-ut.

Elon Musk

Ndërsa Elon Musk nuk ka komentuar drejtpërdrejt mbi thashethemet, Bloomberg raportoi se zyrtarët në Pekin po shqyrtojnë nëse do të lejojnë shitjen e platformës. Me marrëdhëniet e tij të gjera me Kinën dhe aftësitë për të zhvilluar teknologji të avancuara si xAI, Musk mund të jetë një kandidat i

favorshëm për të marrë pronësinë e TikTok-ut në SHBA.

Investitorë nga Shark Tank

Kevin O'Leary, një investitor i njohur nga emisioni Shark Tank, së bashku me një grup të quajtur The People's Bid for TikTok, kanë dorëzuar një ofertë për blerjen e platformës. Grupi ka propozuar të blejë TikTok-un pa algoritmin e tij, duke e zëvendësuar atë me teknologji të zhvilluar nga kompanitë amerikane. Megjithatë, ekspertët paralajmërojnë se kjo mund të jetë sfiduese, pasi algoritmi kinez është çelësi i popullaritetit të aplikacionit.

Perplexity AI

Një kompani rishtare amerikane e motorëve të kërkimit, Perplexity AI, ka paraqitur një ofertë për t'u bashkuar me TikTok US. Në këtë propozim, shumica e aksionerëve të ByteDance do të ruanin pjesët e tyre, ndërsa Perplexity do të përdorte videot e platformës për të përmirësuar modelet e saj.

Qeveria Amerikane?


Presidenti Trump ka sugjeruar në platformën e tij Truth Social që SHBA mund të marrë një pjesë pronësie prej 50% në një sipërmarrje të përbashkët me TikTok. Megjithatë, detajet mbi këtë

propozim mbeten të paqarta dhe nuk janë dhënë informacione shtesë nga administrata e tij.

Të tjerë të interesuar

Gjatë diskutimeve të ndalimit të TikTok-ut në Kongres, edhe emra të tjerë të fuqishëm si ish-drejtori ekzekutiv i Activision Blizzard, Bobby Kotick, dhe ish-sekretari i Thesarit, Steven Mnuchin, kanë shfaqur interes për të bërë një ofertë.

Pavarësisht se kush do të jetë blerësi përfundimtar, shitja e TikTok-ut është kthyer në një temë kryesore që po përshkallëzon tensionet ekonomike dhe politike midis SHBA-së dhe Kinës. /bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Skitarja Lirika Deva arrin normën olimpike

Skitarja e Kosovës në disiplinën e Sllallomit, Lirika Deva, ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm, duke siguruar normën Olimpikë në 6 gara të ndryshme. Ky

rezultat impresionues është një arritje historike për sportin shqiptar dhe një çast krenarie për sportin e Kosovës. Me këtë normë të siguruar, Lirika tashmë ka

mundësinë të garojë në Lojërat Olimpikë dhe ta përfaqësojë vendin në eventet më të rëndësishme ndërkombëtare. Për më tepër, kjo normë i hap

rrugën për pjesëmarrje në Kampionatin Botëror të Skiut në Saalbach 2025, ku do të mund të rivalizojë me disa nga atletët më të mëdhenj të botës. Ky sukses i Devës vjen

pas një periudhe përgatitore intensive dhe angazhimi të jashtëzakonshëm, duke e bërë atë një ndër shpresat më të mëdha për sportin e Kosovës në nivel ndërkombëtar.

FHK-ja e organizon fazën ndërkontinentale të IHF Trophy



“Duke ditur se ngjarja është kualifikuese për Kampionat Botëror, kjo është një tjetër mundësi e artë që bëhet e mundur falë bashkëpunimit të shkëlqyer që kemi me IHF-në dhe falë punës shembullore që kemi bërë me organizimet e deritashme”, ka thënë Eugen Saraçini, president i FHK-së

PRISHTINË, 23 JANAR - Nuk kanë të ndalur sukseset e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Pas bisedave që presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini, ka zhvilluar me drejtues të lartë të Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit (IHF), të enjten u mor vendimi që faza ndërkontinentale e kampionatit IHF Trophy të zhvillohet në Prishtinë. Ndërkohë ka ardhur edhe konfirmimi nga IHF-ja. Faza interkontinentale e IHF Trophy për hendbollistët e grupmoshës U20 dhe U18 do të zhvillohet në kryeqytetin e Kosovës prej 10

deri më 16 mars. Do të paraqiten skuadrat më të mira të kësaj gare nga të gjitha kontinentet. “Duke ditur se ngjarja është kualifikuese për Kampionat Botëror, kjo është një tjetër mundësi e artë që bëhet e mundur falë bashkëpunimit të shkëlqyer që kemi me IHF-në dhe falë punës shembullore që kemi bërë me organizimet e deritashme”, ka thënë Eugen Saraçini, president i FHK-së. Kosova U18 të shtunën e siguroi titullin e kampionit në IHF Trophy për zonën evropiane. Me këtë sukses u kualifikua për

fazën ndërkontinentale. Kosova që fiton fazën ndërkontinentale kualifikohet në Kampionat Botëror. Ky edhe është synimi i radhës i federatës dhe Përfaqësueses së Kosovës. Ekipet përfaqësuese të hendbollit tashmë kanë arritur dy herë të kualifikohen në Botëror, ndërkohë që në sportet e tjera ekipore kjo nuk është arritur ende. Në Botërorin në Spanjë është paraqitur Kosova U21 të hendbollistët, ndërsa në Botërorin në Kinë u paraqit Përfaqësuesja U18 e hendbollistëve.

SHKURT

Behrami në mars debutoi në boksingun profesionist

Boksieri i njohur nga Kosova, Patriot Behrami, më 15 mars do të debutojë në boksingun profesionist. Lajmin e ka dhënë trajneri Besim Brahimi në “Facebook”. “Boksieri ynë Patriot Behrami, i cili është me më së shumti përvojë dhe tituj në boksingun vendor amator, po fillon karrierën në boksingun profesionist më 15 mars. Ne si klub do t'i qëndrojmë pas me mundësitë tona. E falënderojmë ish-boksierin kosovar, tani menaxherin e boksingut profesionist, Shpejtim Shalën, për përkrahjen në këtë drejtim. Sukseset trimi ynë”, ka shkruar Brahimi.

Leotrim Krasniqi, trajneri i ri i FC Liria

FC Liria ka paraqitur trajnerin e ri Leotrim Krasniqi. Ky i fundit ditë më parë u shkarkua nga detyra e trajnerit të KF Vëllaznimit dhe tash e zëvendëson Bledar Devollin në ekipin prizrenas. “Një epokë e re fillon për FC Liria! Me një vizion të qartë dhe një mentalitet fituesi, trajneri ynë i ri është gati ta udhëheqë ekipin drejt suksesit të mëdha. Puna, përkushtimi dhe ambicia do të jenë themelet e këtij rrugëtimi, ku çdo ndeshje do të jetë një betejë dhe çdo fitore një hap më afër objektivave tona!”, thuhet në njoftimin e FC Liria.

Inzaghi: Besoj shumë tek Asllani

Interi mposhti me rezultat 0-1 Sparta Pragën. Me 16 pikë në 7 javë, tani Interit i mjafton vetëm një pikë në sfidën e fundit kundër Monacos për t'u kualifikuar direkt në fazën e 1/8. Simone Inzaghi, trajneri i Interit, u shfaq i kënaqur për këtë sukses, ndërsa nuk harroi as t'i dilte në krah Kristjan Asllanit, i shumëkriticuar në këtë periudhë: “Jemi shumë pranë një rezultati të madh. Na duhet vetëm një pikë, por e kemi vetë në dorë fatin tonë. Kjo nuk ishte e lehtë, por kemi zhvilluar 7 ndeshje në mënyrën e duhur. Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e djemve. I bëra komplimentet e mia”. “Asllani? Po bën gjëra të mira, po punon shumë mirë. Sigurisht mund edhe të gabosh ndonjë ndeshje, por ai është gjithnjë gati. Ai punon shumë. Nëse nuk do të ishte ndëshkuar me të verdhë, do ta lija më gjatë në fushë. Unë kam shumë besim tek ai, edhe shoqëria”, u shpreh Inzaghi.

Programi ‘Trajner sportiv’ po vazhdon me sukses

Prishtinë, 23 janar - Më 15 janar ka përfunduar me sukses semestri dimëror 2024/2025 i programit të edukimit “Trajner sportiv”, ku mbi 40 kandidatë janë duke vijuar ligjëratat tri herë në javë. Programi, i themeluar nga Akademia Olimpikë, e cila vepron në

kuadër të KOK-ut, ka nisur për herë të parë në tetor të vitit të kaluar dhe po ecën me hapa të sigurt drejt formimit të trajnerëve të ardhshëm. Prej 23 janarit deri më 23 shkurt kandidatët do t'u nënshtrohen provimeve në shtatë module si: Anatomia dhe fiziologjia e

njeriut, Pedagogjia sportive, Psikologjia sportive, Menaxhimi në sport, Biomekanikë sportive, Metodat e punës së trajnerit në sport dhe Matjet dhe testimet në sport. Semestri i dytë nis më 1 mars dhe përfundon më 30 maj 2025.



Ish-futbollisti zviceran: Xhaka mund t'i bashkohet Realit

CYRIH, 23 JANAR - Ish-futbollisti zviceran Marco Streller mendon se Xhaka mund t'i bashkohet Real Madridit. Ai ka theksuar se nuk është çudi nëse karriera e Xhakës do të vazhdonte te Real Madridi. "Mund ta imagjinoj mirë se nëse Xabi

Alonso shkon te Real Madridi dhe Luka Modriç largohet, mund të ndodhë", ka thënë ish-sulmuesi i Zvicrës, Baselit, Kolnit, Stuttgartit dhe Thunit për mediumin zviceran "bluewin". Ai është pyetur sërish nëse Xhaka mund t'i

bashkohet Realit. "Mund të jetë patjetër. Alonso e di se Graniti ishte vendimtar në suksesin e Leverkuseni", është shprehur Streller. Që nga transferimi nga Arsenalit te Leverkuseni, Xhaka ka qenë lider i mesfushës së ekipit të drejtuar nga Xabi

Alonso. Ai udhëhoqi ekipin drejt titullit të kampionit të Gjermanisë. Leverkuseni fitoi edhe Kupën, ndërsa humbi në finale të Ligës së Evropës nga Atalanta. Leverkuseni edhe këtë edicion është në garë për titull në Gjermani.



Guardiola: Jemi të rrezikuar, kemi grumbulluar pak pikë. Enrique: Ishte ndeshje e çuditshme

PARIS, 23 JANAR - Trajneri i PSG-së, Luis Enrique, ka shprehur lumturi me fitoren e madhe që e arriti në Ligën e Kampionëve ndaj Manchester Cityt. Klubi francez, edhe pse ishte në disavantazh prej dy golash, arriti ta përmbysë rezultatin dhe ta fitojë ndeshjen me rezultat 4-2. "Nuk di se si ta them në frëngjisht, por kjo ndeshje ishte shumë e çuditshme. Pjesa e parë ishte e vështirë për të dyja skuadrat, por me fillimin e pjesës së dytë pësuam dy gola të shpejtë. Ishte e pabesueshme dhe e padrejtë. Por me ndihmën e tifozëve, të cilët dua t'i falënderoj pasi ishin fantastikë, ne arritëm ta përmbysnim ndeshjen, ndaj fitoren ia dedikoj atyre", ka thënë Enrique, skuadra e të cilit tashmë ka grumbulluar 10 pikë në garën më të fortë në futboll. Ndërkohë momenti negativ nuk ka fund për Manchester Cityn dhe trajnerin Pep



Guardiola, me spanjollin që jo vetën nuk fsheh zhgënjimin, por paralajmëron edhe faktin se skuadra e tij ka shanse reale për t'i thënë lamtumirë Ligës së Kampionëve përpara kohe. "Ne kemi sfidën e fundit ndaj Brugge dhe me shpresë mund të arrijmë të kualifikohemi. Nëse nuk do të fitojmë, do të thotë se nuk e meritojmë të shkojmë më tej. Na duhet të

pranojmë, ne kemi grumbulluar shumë pak pikë deri tani, ndaj jemi të rrezikuar. PSG-ja ishte më lart sesa ne dhe kur një skuadër luan më mirë sesa ti, atëherë nuk të ngelet gjë tjetër vetëm sesa ta pranosh verdiktin", ka thënë Guardiola. Klubi anglez mbetet prapa, teksa për momentin është jashtë zonës "play-off", në vendin e 25, me 8 pikë.

Alexander Shai me 54 pikë i jep fitoren Oklahomës, humbasin Warriorsi e Clevelandit

OKLAHOMA CITY, 23 JANAR - Skuadra e Clevelandit u mund me rezultat 109-108 nga Houstoni në sekondat e fundit të ndeshjes. Garlandi realizoi 26 pikë për kryesuesit e NBA-së, por që s'mjaftuan, ndërsa për vendasit 6 lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Van Vleet me 26 pikë më i miri). Pa probleme fitoi Oklahoman, skuadra që kryeson renditjen në Perëndim, që mundi me rezultat 123-114 Utah Jazzin. Ndeshje magjike për Alexander Shain, që realizoi 54 pikë për skuadrën e Thunderit, protagonist absolut i këtij sezoni. Pas kohës shtesë fitoi Bostoni, që triumfoi me rezultat 117-113 ndaj Clippersave. Dyshja Brown - Tatum realizoi 49 pikë së bashku. Në sekondat e fundit fitoi edhe Minnesota, që



mundi me rezultat 115-114 Dallasin jashtë fushës, sfidë ku u dallua McDanielsi me 27 pikë. Nuk

zhgënjëu ekipi i Phoenixit, që falë 32 pikëve të Bookerit dhe 24 të Durantit, mundi me shifrat 108-84 Brooklynin. Vazhdon sezoni me hope i Golden States, që u mund me shifrat 123-117 nga Sacramento, sfidë ku DeRozani realizoi 32 pikë.

REZULTATET

Atlanta - Detroit	104-114
Brooklyn - Phoenix	84-108
Dallas - Minnesota	114-115
Houston - Cleveland	109-108
Memphis - Charlotte	132-120
New Orleans - Milwaukee	(e shtyrë)
Oklahoma - Utah Jazz	123-114
Sacramento - Golden State	123-117
Clippers - Boston	113-117

SHKURT

Muslija mund të largohet nga Freiburgu, kërkohet nga Bochumi

Florent Muslija mund të largohet nga Freiburgu pas një viti qëndrimi te kjo skuadër. Mesfushori nga Kosova luan thujt në çdo ndeshje, por nuk është një titullar i rregullt dhe gjithmonë pret rastin nga banka rezervë. Muslija ka luajtur 11 ndeshje këtë edicion për Freiburgun, por nuk ka shënuar ose asistuar në asnjërën nga to. Ylli dardan është duke u kërkuar nga Bochumi, një tjetër skuadër në Bundesliga që ka për synim t'i shmanget rënies. Mediet e ndryshme në Gjermani kanë raportuar se reprezentuesi nga Kosova mund të huazohet te Bochumi në mënyrë që t'i ndihmojë kësaj skuadre për të qëndruar në Bundesliga. 26-vjeçari më parë ka luajtur edhe për Karlsruher SC, Hannover 96 dhe Paderborn. Kjo javë pritet të jetë vendimtare për të ardhmen e reprezentuesit nga Kosova i cili në Bochum do të mund të luante më shumë dhe ta rikthente formën e dikurshme.

Chelsea e vëzhgon Ernest Muçin

Një lajm i bujshëm është duke qarkulluar në mediet turke, i cili bën fjalë për talentin shqiptar Ernest Muçi. Raportohet se në duelin që Beshiktashi e zhvilloi ndaj Athletic Bilbaos, ka pasur të pranishëm në shkallët e stadiumit zyrtarë të Chelseat, të cilët e kanë ndjekur nga afër futbollistin pogradecar, i cili u aktivizua titullar, duke bërë një paraqitje tepër dinjitoze, përcjell "Panorama". Sulmuesi i Kombëtares shqiptare është në llupën e klubit të madh të Premierligës, teksa një transferim te "Blues" do të ishte qershia mbi tortë për futbollistin. Gjithsesi mbetet të shihet me mjaft interes se si do të jenë zhvillimet e merkatos në vijim.

Arteta: Arsenali bëri një hap të madh në Ligën e Kampionëve

Arsenali mposhti 3-0 Dinamo Zagrebin dhe në këtë mënyrë arriti një fitore të rëndësishme në fushë, duke u kualifikuar mes tetë më të mirave në Ligën e Kampionëve. Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, e vlerëson shumë të rëndësishme këtë ndeshje dhe fitore: "Jam shumë i lumtur në përgjithësi. Është një hap masiv ajo që kemi bërë në këtë ndeshje. Na ka vënë në një pozicion shumë të mirë përpara se të luajmë ndeshjen e fundit ndaj Gironas. Është shumë bukur të shënosh tre gola duke krijuar shumë raste dhe duke dominuar lojën. Dhe duke mos pranuar asnjë goditje në portë në këtë ndeshje të Ligës së Kampionëve të luajtur para tifozëve tanë, ndaj dhe të gjithë duhet të jemi të kënaqur". "Ne bëjmë disa ndryshime për ta ruajtur freskinë te lojtarët, për t'u dhënë minuta lojtarëve që i meritojnë plotësisht. Kemi pasur disa pengesa me lojtarët që mund t'i përdornim, pasi tre prej tyre ishin në stol, por jo gati për të luajtur. Kjo fitore na rikarikon për ndeshjen ndaj Wolvesit", ka shtuar Arteta.

FIA paralajmëron pilotët: Sharjet dhe protestat dënohen me gjoja, pezullim dhe zbritje pikësh

Beteja e zhvilluar nga presidenti i FIA-s, Mohammed ben Sulayem, për të parandaluar çdo lloj sjelljeje jokorrekte nga pilotët po bëhet gjithnjë e më intensive, veçanërisht pas

rasteve që ndodhën botërorin e kaluar të Formulës 1, pas komenteve të Max Verstappenit dhe Charles Leclercut gjatë konferencave për shtyp. Ndaj, FIA ka publikuar së fundmi rregulla

të reja në lidhje me kodin sportiv, me përditësime të nenit 12.2.1, të cilat mund të rezultojnë në sanksione edhe më të rënda për pilotët e shpallur fajtorë për "sjellje të keqe" ose fajtorë për

shkaktimin e "dëmit moral" për Federatën Ndërkombëtare të Automobilizmit. Dënimet tashmë do të jenë në progresion, duke nisur nga një gjobë 10 mijë euro (shuma

rritet deri në 30 mijë euro), pezullim për një muaj nga kampionati dhe heqje pikësh në Botërorin për Pilotë. FIA kërkon nga pilotët fajtorë që të bëjnë "falje publike dhe refuzim të komenteve".



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 209/1
Dt: 23.01.2025

Në bazë të nenit 95, 96 dhe 97 të Ligjit për Zyrtaar Publik, neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nr.04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), neni 5 dhe 6 të Rregullorës (QRK) nr. 27/2024 për Procedurat Konkurrimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vendi lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
QeK	Qendra e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren	Prizren	Dy (2) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e	Vendi lirë	2

Titulli i pozitës së punës: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e
Klasa/ Koefficienti: I23-3.76
Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar
Orari: 40 orë pune në javë

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit shkollor;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore;
- Ndihmon stafin në rregullimin e orendive të shkollës dhe në realizimin e punëve teknike;
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe punë tjera të cilat i ndan drejtori i shkollës.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma e shkollës e mesme;
- Kopjen e dëshmisë së përvojës së punës (nëse ka përvojë);
- Të ketë shkathtësi pune të pavaruar dhe në ekip;

Dokumente që kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formulari i aplikimit (merret dhe dorëzohet në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (të noterizuara)
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (sjellet nga kandidati pas përzgjedhjes, para nënshkrimit të kontratës)
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit – CV (deri në 30 pikë)
- Intervita me gojë (deri në 70 pikë)

Mënyra e njoftimit me rezultatet:

- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në tabelën e shpalljeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes nga data 24.01.2025 deri me datën 07.02.2025. Aplikacionet duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilin është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendra e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren.

Sqarime shtesë:

- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtaarë Publikë;
- Aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Rahman A. Agushi" B.I. Dardani, Ferizaj në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiak 6.0 MW në Sojevë dhe Mirosalë, Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.03.2025 në ora 11:00 në shkollën fillore e mesme e ulet "Muharrem Shemsedini" fshati Bibaj, komuna e Ferizajt do të organizohet debat publik nga Kompania "Rahman A. Agushi" B.I. Dardani, Ferizaj në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyIMPR68pjZDwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për impiantin fotovoltaiak 6.0 MW në Sojevë dhe Mirosalë, Ferizaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

123/25
23.01.2025

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 122/25 të datës 23.01.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 23.01.2025, shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Mbikëqyrës i Terrenit të Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Numeri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare apo shkollim të mesëm

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Lartësia e pagës mujore: 442.56 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës.
- Siguron që punonjësit e pastrimit të kryejnë detyrat e tyre sipas standardeve të kërkuara të punës.
- Mbikëqyrë cilësinë e shërbimit të mirëmbajtjes të ofruar nga ndërmarrja.
- Koordinon punët ndërmjet ekipeve të mirëmbajtjes.
- Përgatitë raporte për punët që kryhen në kuadër të njesisë së pastrimit.
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave të menaxhmentit të ndërmarrjes.
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 23.01.2025 deri me datë 06.02.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 14.02.2025.
- Afati për ankesë nga data 18.02.2025 deri me datë 20.02.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 28.02.2025.
- Afati për ankesë nga data 04.03.2025 deri me datë 06.03.2025.

- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 14.03.2025.
- Afati për ankesë nga data 19.03.2025 deri me datë 21.03.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.03.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa c njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Rreze Vorfi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

- Danila Pllumbi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. të mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Agim Muharrem Rexhepi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të I, II, të shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Gani Muhamet Delijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari".

- Smajl Osmani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Dy Dëshmorët" Sheremet.

- Rexhep Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dëftesat dhe certifikatën e maturës të sh.m. ekonomike "Kadri Kusari".

- Shkendije islami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Zekeria Rexha".

- Patriot Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Ukshin Miftari" Skivjan.

- Shkendije Islami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore

- Egzon Nagavci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës "Emin Duraku".

- Edonis Makshana shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë dhe njëmbëdhjetë të shkollës së mesme "Selajdin Mullaabazi Mici" Rahovec.

- Alban Jollaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore klasa IX.

- Valdita Elezaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - BllI shfmu "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.

- Kasum Cocaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Violeta Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

123/25
23.01.2025

Na osnovu člana 8, člana 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT-br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i član 8. st. 4, član 11, član 21 pod st. 2.2 i člana 25 Uredbe br. 55/21 o radnim odnosima NPL "Perparimi" Sh. A. u Vuçitrmu odobreno 21.12.2021 od strane Borda direktora NPL "Përparimi" Sh. A., a na osnovu rješenja br. protokola 122/25 od 23.01.2025. godine glavnog izvršnog direktora, NPL "Perparimi" Sh. A. od 23.01.2025., saopštava:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Tercenski nadzornik održavanja – čišćenje kancelarija i objekata

Broj izvršilaca: 1

Radno vrijeme: 40 časova nedeljno

Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Univerzitetska priprema ili srednje obrazovanje

radno iskustvo: Poželjna jedna (1) godina

Izveštava: Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata

Iznos mjesečne plate: 442,56 Euro bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Osposobiti se za obavljanje radnih obaveza sa punim radnim vremenom i bez ograničenja.
- Osigurava da osoblje za čišćenje obavlja svoje dužnosti prema potrebnim standardima rada.
- Nadgledati kvalitet usluga održavanja koje pruža preduzeće.
- Koordinira rad između timova za održavanje.
- Priprema izvještaje o obavljenom radu u jedinici za čišćenje.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća.
- On je odgovoran za posao koji obavlja.
- Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata;

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (potvrda izdata online na platformi e-Kosova će biti prihvaćena)
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

Dokumenti potrebni prije zasnivanja radnog odnosa:

- Dokaz pune operativne sposobnosti.
- Zdravstveni certifikat.

Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 23.01.2025 do 06.02.2024 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 14.02.2025.
- Rok za žalbu je od 18.02.2025 do 20.02.2025.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 28.02.2025.
- Rok za žalbu je od 04.03.2025 do 06.03.2025.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 14.03.2025.
- Rok za žalbu je od 19.03.2025 do 21.03.2025.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 26.03.2025.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za cvaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se pritužba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, žalba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavi formular u Arhivu N.P.L "Perparimi" Sh. A u gradu Vuçitrmu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – lilijala u Vuçitrmu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, dače potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom potrebnom dokumentacijom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese: hrperparimi@gmail.com .

N.P.L "Perparimi" Sh. A u Vuçitrmu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Sva komunikacija tokom postupka javnog nadmetanja odvijat će se putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

Objašnjenje:

Preduzeće ima za cilj da razjasni pitanje termina koji se koriste u rodnom kontekstu, gde reči i naslovi jednog roda uključuju i drugi rod.

Zaključak:

N.P.L "Perparimi" Sh. A u Vuçitrmu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A PEJË
NR. 454
DATA 23.01.2025

Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 24.01.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Kordinator Operativ - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Organizon caktimin e ngasësve në automjete;
- Përpilon orarin e punës së ngasësve dhe mbanë evidencë mbi orët e punës dhe me kohë la dorëzon menaxherit operativ;
- Sipas kërkesës dhe nevojës së procesit të punës përcjell dhe kontrollon kryerjen e punëve në punëtorinë e mirëmbajtjes në ndërrimin e tij;
- Organizon dhe koordinon punën e gjithmbarëshme në bartjen e mbeturinave;
- Kujdeset për angazhimin e plotë të të punësuarëve në funksion të ofrimit në kontinuitet të shërbimit të bartjes së mbeturinave;
- Në bashkëpunim me menaxherët e ndërrimeve, kryepunëtorët dhe përgjegjësit e zonave, harton dhe përcjell zbatimin e orarit të kryerjes së shërbimeve në bartjen e mbeturinave;
- Harmonizon planet operative të shërbimeve në kuptimin e shfrytëzimit optimal të kapacitetit teknik dhe fuqisë punëtore, si dhe zvogëlimin e shpenzimeve operative;
- Përcjellë shfrytëzimin racional të kapacitetit teknik;
- Në bashkëpunim me vartësit plotëson urdhëresat e punës për paga dhe prezencë në punë;
- Detyrohet të inkurajojë zbatimin e kodit etik dhe rregullat e caktuara për këtë proces pune brenda departamentit të tij dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi për raportimin / adresimin e tyre dhe KE;
- Është përgjegjës për rregullsinë teknike të automjeteve dhe pastërtinë e tyre me rastin e daljes në rrugë të automjetit (kamionit);
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga menaxheri operativ.
- Për mos respektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzkuiv

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)

- Shkollim i mesëm – përparësi drejtim nga Fakulteti Teknik;
- Përvoja e punës së paku 2 vite, e dëshmuar;
- Ai/Ajo duhet të ketë përvojë të menaxhimit apo profesioneve relevante, aftësi organizative dhe analitike, si dhe aftësi ndër njerëzore;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com Data e për aplikim është nga 24.01.2025 deri me 10.02.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

